

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010) dhe neneve 39, 40, 41 dhe 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 09 nëntor 2012 miratoi si në vijim:

RREGULLORE PËR BASHKIMET DHE PËRVETËSIMET E BANKAVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurat, të cilat bankat janë të obliguara t'i kryejnë në procesin e bashkimit ose konsolidimit dhe në rast të përvetësimit, për të cilat kërkohet aprovim paraprak nga ana e BQK-së.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në Nenin 3 të Ligjit nr.04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (në vijim: Ligji për bankat) ose / dhe përkufizimeve në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - a) *Bashkimet* - do të thotë bashkim i dy ose më shumë bankave nëpërmjet transferimit të totalit të mjeteve dhe detyrimeve në një banke të re;
 - b) *Përvetësimet* - do të thotë procesi i blerjes ose përvetësimit të një pjese ose një kompanie (shoqëria aksionare) të tërë;
 - c) *Kompanitë j-financiare* - do të thotë kompania që nuk merret me aktivitet financiar.

Neni 3

Bashkimet

1. Banka nuk mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një institucion financiar tjetër ose një kompani tjetër, qoftë brenda apo jashtë Kosovës, pa aprovimin paraprak me shkrim nga BQK-ja.
2. Varësisht prej natyrës së transaksionit, BQK-ja do të përcaktojë se cilat informacione do të kërkohen para se të aprovohet apo jo transaksioni.

3. Nëse qëllimi është krijimi i një banke të re, BQK-ja do të trajtojë atë bashkim si aplikacion për një licencë të re bankare siç përcaktohet me nenin 7 të Ligjit për bankat. Kjo gjithashtu aplikohet nëse qëllimi është të bëhet bashkimi me një bankë të huaj, që rezulton me kryerjen e aktivitetit bankar në Kosovë si subjekt i varur.

4. Kërkesa për aprovim për bankën e riorganizuar nëpërmjet bashkimit duhet të ketë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të bankës dhe institucionit financiar të përfshirë në operacion për aprovimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit;
- b) Marrëveshja/draft dhe raporti i detajuar i procesit të bashkimit, të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjor të bankave të përfshira në procesin e bashkimit. Marrëveshja/ draft dhe raporti përpilohen me shkrim dhe në përshtatje me legjislacionin në fuqi.
- c) Raporti i ekspertëve të pavarur të licencuar në fusha të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e draftmarrëveshjes së bashkimit;
- d) Draftstatuti i bankës pas realizimit, të procesit të bashkimit;
- e) Planet strategjike dhe operative për të kryer bashkimin, ku përfshihen analizat e nevojshme të përvetësimit dhe parashikimet e pasqyrave financiare për bankën e bashkuar;
- f) Në rast të ndryshimit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të bankës së bashkuar, duhet të paraqitet dokumentacioni në përputhje me kërkesat për drejtorët siç është e përcaktuar në Ligjin për bankat dhe me Rregulloren për drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankave;
- g) Struktura e re e aksionarëve të bankës.

5. BQK-ja, gjithashtu do të diskutojë me bankën afatin kohor që do të jetë i nevojshëm për aprovimet paraprake duke lejuar bankën, që të fillojë diskutimet me palën tjetër apo palët e tjera të përfshira pa angazhimin e BQK-së.

6. BQK-ja do të japë aprovimin nëse:

- a) Bashkimi nuk rrezikon gjendjen financiare të bankës së bashkuar;
- b) Banka ka sistem të organizimit, të menaxhimit, të vendimmarrjes dhe të teknologjisë informative, i cili mundëson integrimin komplet të bankës së bashkuar në mënyrë që të mos rrezikojë funksionimin e saj;
- c) Bashkimi është ekonomikisht i arsyeshëm.

7. Është përgjegjësi e bankës që të sigurojë aprovimet tjera nga autoritetet tjera që mund të jenë të nevojshme para përfundimit të transaksionit.

Neni 4

Përvetësimet e interesave në institucione financiare

1. Banka e interesuar në përvetësimin e një interesi, ose rritjen e interesit ekzistues në ndonjë institucion financiar tjetër, qoftë bankë në Kosovë, bankë e huaj ose institucion tjetër financiar në Kosovë ose jashtë duhet ta njoftojë BQK- në në fazën fillestare.

2. Varësisht nga natyra, niveli(sa i përket përqindjes së kapitalit që banka planifikon të përfshijë) dhe madhësia e transaksionit ndaj madhësisë së bankës përvetësuese, BQK-ja do të përcaktojë se cilat informata shtesë janë të nevojshme para se aprovimi të mund të shqyrtohet.
3. BQK-ja shqyrton aplikacionin nga aspekti i ndikimit në kapitalin e bankës investuese, kapacitetit të menaxhmentit të bankës investuese dhe ndonjë ndryshim të parashikuar në bordin e drejtorëve dhe menaxhmentin e lartë të bankës investuese.
4. Kur institucioni në të cilin investohet është gjithashtu i rregulluar me Ligjin për bankat, BQK-ja shqyrton edhe përshtatshmërinë e bankës investuese si aksionar i institucionit në të cilin investohet në pajtueshmëri me nenet relevante të Ligjit për bankat.

Neni 5

Përvetësimet e interesit të kapitalit nga bankat në shoqëritë (kompanitë) jo financiare

1. Për përvetësimet e interesit të kapitalit të bankave në shoqëritë jo financiare, bankat duhet të veprojnë në pajtueshmëri me Nenin 41 të Ligjit për bankat, nëse transaksioni tejkalon limitet e Nenit 41 të Ligjit për bankat, institucioni duhet menjëherë të informojë dhe të konsultohet me BQK-në për mënyrën e sjelljes së bankës në pajtueshmëri të plotë.
2. Kur banka është anëtarë i grupit i cili është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar sipas Rregullores së BQK-së për Mbikëqyrjen e Konsoliduar, BQK-ja do të ketë parasysh pronësinë sipas kërkesave të Nenit 41 të Ligjit për bankat, në mbikëqyrje të grupit bankar.

Neni 6

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e kësaj rregulloreje është subjekt i masave përmirësuese dhe dënimeve të përcaktuara me Nenet 58, 59 dhe 82 të Ligjit për bankat.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me datë 03 dhjetor 2012.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Gazmend Luboteni